LIGJ
Nr.9408, datë 19.5.2005

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8701, DATË 1.12.2000 "PËR LOJËRAT E FATIT, KAZINOTË DHE HIPODROMET", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8701, datë 1.12.2000 "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", i ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Paragrafi i parë, paragrafi i dytë, paragrafi i katërt dhe paragrafi i pestë të pikës 1 të nenit 3 shfuqizohen.

Neni 2

Neni 10 "Ndarja e të ardhurave" ndryshohet si më poshtë:

"Neni 10
Detyrimet tatimore

1. Tatim-fitimi i shoqërisë (organizatorit) llogaritet dhe paguhet në përputhje me dispozitat e ligjit nr.8438, datë 25.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

2.Të ardhurat, që përfitohen nga lojtarët apo fituesit, që marrin pjesë në lojërat e fatit dhe kazinotë, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat.

3.Veprimtaritë e lojërave të fatit, që tatohen sipas dispozitave të këtij ligji, përjashtohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

4.Detyrimet tatimore janë:

a) Për lojërat aritmetike:

i) organizatori i lojës bingo, që zhvillohet për pjesëmarrës brenda sallës, paguan një tatim për lojërat e fatit, me një kuotë fikse, çdo muaj, për çdo sallë, përkatësisht 250 000 lekë për rrethet e kategorisë së parë, 200 000 lekë për rrethet e kategorisë së dytë dhe 150 000 lekë për rrethet e kategorisë së tretë;

ii)organizatori i lojës bingo, që nuk zhvillohet për pjesëmarrës brenda sallave, paguan tatim për lojërat e fatit 20 për qind mbi vëllimin e qarkullimit, gjithsej, të realizuar në bazë të arkëtimeve nga shitja e biletave.

Organizatori, për çdo lojë, duhet t'u kthejë lojtarëve, në formën e fitimit, jo më pak se 50 për qind të shumës së vënë në lojë;

b) për lojërat e fatit, sportive:

i)organizatori i konkurseve të parashikimeve sportive paguan tatim mbi lojërat e fatit 20 për qind mbi vëllimin e qarkullimit, gjithsej, të realizuar në bazë të arkëtimeve nga shitja e biletave. Organizatori, për çdo konkurs, duhet t'u kthejë lojtarëve, në formën e fitimit, jo më pak se 50 për qind të shumës së vënë në lojë;

ii) organizatori i basteve sportive paguan tatim mbi lojërat e fatit me kuotë fikse, si më poshtë:

-500 000 lekë çdo muaj për shoqërinë;

- 20 000 lekë për çdo pikë shitjeje të basteve, për rrethet e kategorisë së parë;

- 15 000 lekë për çdo pikë shitjeje të basteve, për rrethet e kategorisë së dytë;

- 10 000 lekë për çdo pikë shitjeje të basteve, për rrethet e kategorisë së tretë.

Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për zhvillimin e sporteve, i kalojnë në favor 2 për qind të shumave të grumbulluara sipas shkronjës "b" të pikës 4 të këtij neni;

c) për lojërat elektronike me fitim në çast:

Organizatori i lojërave elektronike me fitim në çast paguan një tatim mbi lojërat e fatit, me kuotë fikse, çdo muaj, si më poshtë:

i)për rrethet e kategorisë së parë, 15 000 lekë për çdo kompjuter elektronik, makinë elektronike, si dhe 20 000 lekë për çdo pozicion loje të makinës elektronike;

ii)për rrethet e kategorisë së dytë, 10 000 lekë për çdo kompjuter elektronik, makinë elektronike, si dhe 15 000 lekë për çdo pozicion loje të makinës elektronike;

iii) për rrethet e kategorisë së tretë, 7 000 lekë për çdo kompjuter elektronik, makinë elektronike, si dhe 10 000 lekë për çdo pozicion loje të makinës elektronike.

Në çdo rast, organizatori, për çdo lojë, duhet t'u kthejë lojtarëve, në formën e fitimit, jo më pak se 80 për qind të shumës së vënë në lojë;

ç) për lojërat e fatit të kategorisë lotari:

Organizatori i lojës lotari e çastit dhe lotari, për të cilën hidhet short, paguan tatim për lojërat e fatit 20 për qind mbi vëllimin e qarkullimit, gjithsej, të realizuar në bazë të arkëtimeve nga shitja e biletave. Për çdo lotari, organizatori duhet t'u kthejë lojtarëve, në formën e fitimit, jo më pak se 50 për qind të shumës së vënë në lojë. Për rastet kur shuma në dispozicion të lojtarëve nuk u shpërndahet fituesve, ajo mbartet në lotarinë pasardhëse, si shumë në dispozicion të lojtarëve.

5.Për efekt të dispozitave të shkronjave "a", "b" e "c" të pikës 4 të këtij neni, në rrethet e kategorisë së parë përfshihen Tirana dhe Durrësi, në rrethet e kategorisë së dytë përfshihen Shkodra, Korça, Vlora, Saranda, Gjirokastra, Elbasani, Fieri, Lushnja, Pogradeci, Berati, Lezha dhe Kavaja, ndërsa në rrethet e kategorisë së tretë përfshihen të gjitha rrethet e tjera.

6.Detyrimet tatimore për lojërat e fatit, në përqindje apo në shumë fikse, të paguhen në degën e tatim-taksave, ku është e regjistruar shoqëria (organizatori) jo më vonë se data 10 e çdo muaji për veprimtarinë e realizuar në muajin pararendës.".

Neni 3

Neni 22 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 22

Detyrimi tatimor për kazinotë

1. Tatim-fitimi i shoqërisë (organizatorit) llogaritet dhe paguhet në përputhje me dispozitat e ligjit nr.8438, datë 25.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

2. Të ardhurat, që përfitohen nga lojtarët apo fituesit, që marrin pjesë në lojërat e fatit dhe kazinotë, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat.

3. Veprimtaritë e kazinove, që tatohen sipas dispozitave të këtij ligji, përjashtohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

4. Tatimpaguesit, që ushtrojnë veprimtari në fushën e organizimit të lojërave të fatit në kazino, paguajnë detyrimet tatimore si më poshtë:

a) për çdo tavolinë të lojës së fatit ruletë, një taksë mujore në masën 200 000 lekë;

b) për çdo tavolinë të lojërave me letra dhe me zarë, një taksë mujore në masën 150 000 lekë;

c) për lojërat elektronike dhe slotmakinat me fitim në çast, të vendosura në mjediset e kazinosë, një taksë mujore në masën 15 000 lekë për çdo kompjuter elektronik e makinë elektronike;

ç) për makinat elektronike me më shumë se një pozicion 20 000 lekë për çdo pozicion;

d) bashkisë, ku ushtron veprimtarinë kazinoja, i kalojnë në favor 2 për qind të shumave të grumbulluara, sipas përcaktimeve të shkronjave "a", "b", "c" e “ç” të pikës 4 të këtij neni.".

Neni 4

Neni 25 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 25
Detyrimi tatimor për hipodromet

1. Tatim-fitimi i shoqërisë (organizatorit) llogaritet dhe paguhet në përputhje me dispozitat e ligjit nr.8438, datë 25.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

2.Të ardhurat, që përfitohen nga lojtarët apo fituesit, që marrin pjesë në lojërat e fatit dhe kazinotë, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat.

3.Veprimtaritë e hipodromeve, që tatohen sipas dispozitave të këtij ligji, përjashtohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

4.Tatimpaguesit, që ushtrojnë veprimtari në fushën e organizimit të lojërave të fatit në hipodrome, paguajnë detyrimet tatimore si më poshtë:

a) një tatim loje fati me kuotë fikse, çdo muaj, prej 1 000 000 lekësh për shoqërinë;

b)një tatim loje fati me kuotë fikse, çdo muaj, prej 20 000 lekësh për çdo pikë të vënies së basteve;

c) për lojërat elektronike me fitim në çast, të vendosura në mjediset e hipodromit, një tatim loje fati me kuotë fikse, çdo muaj, prej 20 000 lekësh për çdo kompjuter elektronik, makinë elektronike apo çdo pozicion loje të makinës elektronike;

ç) bashkisë, ku ushtron veprimtarinë hipodromi, i kalojnë në favor 2 për qind të shumave të grumbulluara, sipas përcaktimeve të shkronjave "a", "b" e "c" të pikës 4 të këtij neni.".

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4606, datë 1.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu